



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 45
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II
Prishtinë, më 29 dhjetor 2016, në orën 14:30

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Hatim Baxhaku, Fikrim Damka, Fadil Beka, Mirjeta Kalludra dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan: Besa Baftiu , Adem Hoxha dhe Ali Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë: Rrustem Berisha, deputet, Bekim Haxhiu, deputet, Time Kadrija, deputete, Aida Dërguti, deputete, Faton Topalli, deputet dhe Haxhi Shala, deputet.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

RENDI DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/l -261, për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, para miratimit në parim;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/1 -261, për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, para miratimit në parim;

Flora Brovina, kryetare-Para vetes e keni Projektligjin që ka ardhur nga Qeveria dhe ky Projektligj ka ardhur pak si i ngutshëm, por duket se është edhe një kërkesë nga Fondi Monetar dhe Banka Botërore për një ndryshim në beneficionet e veteranëve. Ky afat i shkurtër nuk na jep mundësi shumë që të konsultohemi edhe me palët e interesit, e hapi diskutimin për shqyrtimin e Projektligjit para miratimit në lexim të parë.

Fikrim Damka - FMN ka vendos kushte që nëse deri në 5 janar 2017, nuk ndryshohet Ligji i Veteranëve, atëherë kredia prej 106 milionë euro do të anulohet, prandaj për këtë arsye ky Projektligj ka ardhur me nguti. Për mua i diskutueshëm është neni 16 A, dhe fshirja e nenit 18. Megjithatë tani ta shqyrtojmë në parim kurse gjatë amendamentimit t'i diskutojmë vërejtjet konkrete për çdo nen.

Rrustem Berisha- Mendoj se nuk është mirë të ndahen veteranët, sepse është investuar shumë në unifikimin e faktorit ushtarak. Nuk duhet të ngutemi dhe Kuvendi të silltet para aktit të kryer. Nuk është në rregull që veteranët me i përça përmes Ligjit. Nëse duhet të ndryshohet Ligji, duhet të ndryshohen vetëm në ato pjesë ku ka bazë ligjore. Nuk e di se ku ka pas UÇK në vitin 1991, por edhe nëse duhet le të përfshihen edhe ata, por nuk duhet të ndahen me kategorizim. Nëse nuk ngutemi mund ta ofrojmë një ligj më të favorshëm.

Time Kadrijaj- Duke dashur ta mbyllim një problem me FMN-në, ne po hapim probleme të shumta që do të na kushtojnë edhe më shumë. Ky Ligj derisa është miratuar ka pasur shumë sfida dhe ka pas shumë dëgjime, ndërsa tani të ndërrohet brenda natës nuk është në rregull. Duhet të dëgjohen edhe veteranët.

Shukrie Bytyçi- Mendoj se nuk duhet të ngutemi, pasi Projektligji që ka ardhur po e ndryshon shumicën e Ligjit në fuqi. Nuk është logjike që Ligji të ndryshohet pa asnjë dëgjim publik me veteranët. Nuk mund të vendosim në këtë mënyrë kaq të ngutshme. Nëse Ligji ka të meta, ne do të punojmë në vazhdimësi, e të mos ngutemi pasi kemi të bëjmë me një Ligj për kategorinë më të çmuar të shoqërisë.

Aida Dërguti - Levizja Vetëvendosje është kundër procedimit të shpejt të ndryshimit të këtij Ligji. I sugjeroj Qeverisë që më mirë është të merret me pastrimin e listave të veteranëve të rrejshëm, e jo të bëj kategorizime të tilla si të papranueshme. Nuk ka lidhje momenti se kur je kyç në luftë sepse nuk e ke ditë se kur do të përfundojë lufta. Ata kanë ardhur të gatshëm për t'u sakrifikuar dhe një diskriminim i tillë i rrit pakënaqësitë dhe nuk është në interes të vendit.

Hatim Baxhaku- Të gjithë jemi në një situatë të vështirë sepse nuk e kemi analizuar mirë Projektligjin, por megjithatë me sa kemi mundur t'i analizojmë disa gjëra, nuk po më duken në rregull si çështja e 50% të pensionit për atë që punon e shumë çështje tjera. Mendoj se ka shumë konfuzion edhe në shumë çështje. Me miratimin e tij mos po bëjmë më shumë dëme sesa përfitime nga fondet e FMN- së. Ne mund ta dërgojmë në lexim të parë në Kuvend, e pastaj të shohim se çfarë mund të ndryshojmë.

Haxhi Shala- Nuk është e ndershme të shqyrtohet një ligj pa prezencën e shoqatave dhe pa përfaqësuesit e Qeverisë. Nuk mendoj që edhe çështja e FMN-së qëndron. Ju sugjeroi që ky ligj në këtë formë si është të mos kalojë.

Flora Brovina- Fillimisht ta lexojmë nen për nen dhe të njoftohemi me Projektligjin e pastaj të vendosim për procedim të mëtejshëm.

Faton Topalli - Disa nene brenda Projektligjit kanë edhe kundërthënie , dhe nuk është në rregull që nga pensioni të përjashtohen ata që jetojnë jashtë vendit.

Kryetarja-Mendoj se do ta bëjmë një pauzë dhe do të kemi disa konsultime shtesë me grupet parlamentare.

U njoftuam zyrtarisht që në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit kanë marrë pjesë shoqatat e veteranëve të luftës dhe janë pajtuar me këto ndryshime. Nëse pajtoheni, ne në parim mos ta pengojmë ligjin të shkojë në Kuvend për diskutim.

Rrustem Berisha - Nuk është e vërtetë që shoqatat janë pajtuar me këtë kategorizim. Ata janë pajtuar që të bëhet kategorizimi 1991 deri 1998 dhe 1998 deri në përfundim të luftës. Edhe në Këshillin Drejtues të Shoqatës së Veteranëve nuk është diskutuar Projektligji, prandaj të mos themi se janë pajtuar shoqatat.

Hatim Baxhaku- Edhe më herët e thashë se ky Projektligj do të krijojë më shumë probleme sesa që ka me zgjidh situatën . Do të ketë edhe kosto shtesë buxhetore, mirëpo unë do ta votojë në parim, por gjatë amendamentimit nëse përfshihen amendamente e nevojshme, atëherë do ta votojë.

Mirjeta Kalludra- Mendoj se në parim duhet të përkrahet, por mendoj se gjatë amendamentimit duhet të ndryshohen disa nene, sidomos kategorizimi.

Fadil Beka - Edhe unë e mbështes të shkojë në parim në Kuvend, por gjatë amendamentimit do të japim kontributin që të kemi një ligj sa më të mirë.

Shukrije Bytyçi - Edhe unë, por edhe partia NISMA nuk e përkrahim këtë Projektligj në formën si ka ardhur, sepse ne jemi të interesuar të zgjidhim probleme e jo të shkaktojmë probleme.

Rrustem Berisha - Qëndrimi jonë si AAK është se nuk e përkrahim këtë Projektligj në këtë formë si është dhe në procedurë të përshpejtuar. Nuk pajtohemi të ndahen veteranët dhe jemi që të bëhet një Ligj sa më i mirë dhe i përshtatshëm për të gjithë veteranët.

Fikrim Damka - Ta përkrahim në parim dhe ta dërgojmë në Kuvend për diskutim dhe ta dëgjojmë edhe kryeministrin edhe ministrin si po e arsyetojnë.

Kryetarja - Projektligji ka ardhur me një shpejtësi të madhe, por në parim nuk po e ndalim e pastaj të shohim procedimin e mëtejshëm.

Pas diskutimeve, Komisioni, me 5 vota për, dhe një abstenim, miratoi në parim para leximit të parë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-261, për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Flora BROVINA